

AKT- THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Yoo Taxi” shpk

Ne Durrës, sot me datë 15/01/2025

Z. Mariglen Malluta, i datelindjes **27/02/2000** ne Shijak, banues ne Durrës, shtetas/e **Shqiptar/e** identifikuar me pasaporte ose karte identiteti ne **nr.personal K00227051K** madhore, me zotesi juridike për të vepruar.

Z. Bukurosh Malluta i datelindjes **10/02/1971**, lindur ne Librazhd, banues ne Durres, shtetas/e **Shqiptar/e** identifikuar me pasaporte ose karte identiteti **H10210084O** madhore, me zotesi juridike për të vepruar.

Te cilet me cilesine e “Ortakeve themelues” kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaruan se me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor,Fiskale Tatimor, rane dakorte te themelojne shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, **“Yoo Taxi” shpk**.

KREU I

Neni 1

Krijimi

“Yoo Taxi” shpk

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).Emertim i shoqerise do te jete I stampuar dhe ne vulen e saj.


Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj, Shoqeria **“Yoo Taxi” shpk**, Pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te tretëve detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj, për të cilat përgjigjet brënda kufijve të përcaktuar në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 si dhe akte të tjera ligjore.

Neni 3

Selia



Shoqeria e ka seline ne: Lagjja 13, Rruga Syra, Nr.8 Kati i pare, Plepa, Durres. Shoqeria Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj sipas vullnetit te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shërbime në fushën e transportit të udhëtareve. Shërbime taksi për publikun si brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj. Transporti urban dhe interurban në funksion të shërbimit Taxi të udhëtarëve, në përputhje me çdo ligj të zbatueshëm dhe rregulloreve të fushës përkatëse. Tregti dhe dhënie me qira e automjeteve. Tregtim me shumicë dhe pakice, import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, impianteve/paneleve fotovoltaike, elektroshtëpiake, elektronike, sistemeve/impianteve termike. Import eksport mallra e pajisje të teknologjise në fushën energjitikës etj, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen, dhe menaxhimin e centralit me impjante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme. Lavazh per larjen e makinave.

Çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizmin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij për një periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.

KREU II

Neni 6


Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 150.000 (njëqind mije) leke, i ndare ne 2 kuota.

Kapitali themeltar i shoqërisë, është kontribut i 2 (dy) Ortakeve te shoqërisë, me kuota si me poshtë:

1. Ortaku themelues Mariglen Malluta zotëruesi i 1 (një)kuote me vlere te përgjithshme 90.000 (nëntëdhjetë mije) leke ne para qe përben edhe 60% te kapitalit themeltar te shoqërisë ,
2. Ortaku themelues Bukurosh Malluta zotëruesi i 1 (një)kuote me vlere te përgjithshme 60.000 (gjashtëdhjetë mije) leke ne para qe përben edhe 40% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregetueshme. Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme te paluajtshme apo te



drejta). Ortaket pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te kapitalit themeltar te shoqerise.

Asambleja e ortakeve mund te vendose qe zmadhimi i kapitalit te kryhet me emetim te aksioneve te reja, per t'u nenshkruar vetem nga aksionarët ekzistues.

2. Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund te kryhet vetem me miratimin unanim te te gjithë ortakeve

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortaketve, e cila merr vendimin ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

KREU II


Neni 8

Organi Vendimmarres

Organet drejtuese te Shoqerise "Yoo Taxi" shpk jane:

- 1. Asmableja e Pergjitheshme.
- 2. Shoqeria do te kete nje administrator me te drejta te plota.

Administratori **Znj. Kesiana Ymeraj** per nje periudhe 5(pese) vjecare. 15/01/2025-15/01/2030.



Asambleja e Pergjitheshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretit ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi i shoqërisë

Administrator I shoqërisë emerohet Znj. Kesiana Ymeraj e cila deklaron se pranon rolin e ngakuar dhe se nuk ekzistojnë shkaqe të ligjshme që mund ta shpallin të pavlefshme.

Afati i emerimit të Znj. Kesiana Ymeraj si administratore është 5(pese) vjet 15/01/2025-15/01/2030, administratorët emerohen për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripertritje.

Administratorët emerohen dhe shkarkohen me vendim të Ortakëve themelues të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:





- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.
5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.
6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe perfundon në 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet në 31 dhjetor.

Neni 12



Prishja e shoqërisë

Shkaqet e prishjes së shoqërisë Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë nëpërputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

Neni 13

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare"(i ndryshuar)

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 2 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mesipërmasi miratohet në parim dhe nën parimin nga Ortaket themelues të shoqërisë tregtare "Yoo Taxi" Shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

ORTAKET

Bukurosh Malluta

Mariglen Malluta

